



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2304/7 prot

Datë 08.10.2025

V E N D I M
Nr. 1409/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.10.2025 mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “One Albania” SHA në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Abissnet” SHA, në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “One Albania” SHA, në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Sh.A Posta Shqiptare me adresë Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë

Ankimues:

Operatori ekonomik “One Albania” SHA me NIPT J61814094W dhe adresë: adresë Nj.Ad. 11, Rruga “Vangjel Noti”, ndërtesa nr. 20, 1026, Laprakë, Tiranë.

Operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK me NIPT K72223007O dhe adresë Nj.Ad. 5, Rruga “Pjetër Bogdani”, godina nr 3, Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Abissnet” SHA me NIPT K01417001C dhe adresë: Nj.Ad. 5, Rruga “Ismail Qemali”, Pallati 18, Kati II, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomik kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09-05-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet - Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

II.2 Në datën 17-07-2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 08.08.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “One Albania” sh.a	71,995,200	lekë	skualifikuar
2. “MC NETWORKING” shpk	83,619,173.80	lekë	skualifikuar
3. “Abissnet” sh.a	93,831,840	lekë	kualifikuar
4. “Vodafone Albania” sh.a	119,100,000	lekë	skualifikuar
5. “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k	119,700,457.00	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 18.08.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 27.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2304/2025 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5736 e operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet - Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “One Albania” SHA, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të “Abissnet” SHA.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2304/1 datë 28.08.2025, lidhur arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “ONE ALBANIA” SHA kundërshton me anë të ankesës, si dhe kriteret kualifikuese për të cilat pretendohet se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Abissnet” SHA.

II.7. Në datën 27.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2307/2025 protokoli, datë 28.08.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5737 e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet - Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në**

Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2307/1 datë 28.08.2025, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK kundërshton me anë të ankesës, si dhe kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.

II.9. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2304/2 prot., datë 03.09.2025.

II.10. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2304/3 prot., datë 03.09.2025

II.11. Me shkresën me nr. 843/28 prot., datë 04.09.2025 me lëndë “Shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 2304/4 prot., datë 08.09.2025 drejtuar operatorit ekonomik “One Albania” SHA dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “One Albania” SHA nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.12. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2307/2 prot., datë 03.09.2025.

II.13. Me shkresën me nr. 843/29 prot., datë 04.09.2025 me lëndë “Shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 2307/3 prot., datë 08.09.2025 drejtuar operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.14. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin administrativ rezulton se janë paraqitur argumente nga subjekti i interesuar “Abissnet” SHA në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “One Albania” SHA për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit me arsyetimin se: “...Pika 2.3.5 e DST-së “Për Kapacitetin Teknik” parashikon se: “Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar dhe sekondar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDOS në disa perimetra sigurie (multi-layer DDOS protection, ne të gjithë perimetrat e sigurisë (lokale, kombetare dhe nderkombetare). Gjithashtu për platformen e përdorur për ofrimin e shërbimit DDOS, edhe në kushtet kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformës, Operatori Ekonomik duhet ta provojë duke paraqitur dokumentacion të plotë provues. Në rastin e blerjes së platformes nga të tretë të paraqese kontratën e blerjes/suportit të platformes respektive për mbrojtjen DDOS (me një kompani/ofrues shërbimi e cila duhet të disponojë autorizim rishitje apo prodhuesi). Në rastet kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformës, të paraqitet një përshkrim i detajuar se si është hartuar zgjidhja, hardëare dhe softëare që përdoren, struktura dhe bllokskema se si funksionon zgjidhja, si edhe certifikimin përkatës dhe akreditimin nga

organet ndërkombetare lidhur me produktin e prodhuar nga Operatori. Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik për këtë shërbim, kontratës së blerjes/suportit të platformës respektive si edhe autorizimin si rishitës/prodhues për 3 kompaninë me të cilën operatori ekonomik pjesëmarrës ka marrëveshje për këtë shërbim.” Në lidhje me pikën e mësipërme Operatori Ekonomik “One Albania” sh.a., ka ngarkuar në sistem: - Marrëveshjen e lidhur midis “One Albania” sh.a. dhe “Verso” sh.p.k. “Për blerjen dhe zgjidhjen e mbrojtjes DDOS”; - Letër Autorizimi të lëshuar nga kompania “A10 Netëorks” Inc që konfirmon se Verso Altima d.o.o (kompani që operon në Kroaci) është rishitës i autorizuar për produkte të A10 Netëorks - Ekstakt të QKB për kompaninë “Verso” sh.p.k. Referuar ligjit të Prokurimit publik, neni 54, pika 2 dhe nenit 67, thuhet shprehimisht se : Neni 54 – Përdorimi i kapaciteteve të subjekteve të tjera ekonomike Pika 2 Dokumentet që vërtetojnë kapacitetet teknike dhe profesionale, si dhe përvojën e mëparshme, duhet të jenë drejtpërdrejt të lidhura me operatorin ekonomik pjesëmarrës në procedurë, përveç rasteve kur ky mbështetet në kapacitetet e një subjekti tjetër ekonomik në përputhje me nenin 67 të këtij ligji. Citim nga neni 67, Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik":

1. Operatorët ekonomikë mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera ekonomike, pavarësisht nga natyra juridike e lidhjes së tyre, për të përmbushur kriteret për kualifikim në lidhje me kapacitetin ekonomik e financiar dhe aftësinë teknike e profesionale.
2. Nëse operatori ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera ekonomike, ai duhet të paraqesë në ofertën e tij deklaratë të tillë dhe dokumente që vërtetojnë angazhimin e subjektit tjetër ekonomik, që ky i fundit do të vërë në dispozicion burimet e kërkuara për realizimin e kontratës.
3. Subjekti tjetër ekonomik duhet të paraqesë deklaratë angazhimi në formën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, ku përcaktohen burimet e vëna në dispozicion dhe përgjegjësia e tij gjatë ekzekutimit të kontratës. Për sa më sipër pika 2.3.5 konsiderohet e papërmbushur pasi në dokumentacionin e dorëzuar nuk vërtetohet lidhja midis rishitësit të autorizuar Verso Altimo Doo edhe kompanisë me të cilën Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurë ka ardhur me marrëveshje Verso Shpk. Pra, lidhja midis “Verso” sh.p.k. që operon në Shqipëri dhe “Verso Altima” d.o.o që operon në Kroaci nuk rezulton e verifikueshme përveç një ekstrakti të ngarkuar në sistem ku përsëri nuk dëshmohet Verso Altima d.o.o ka dhënë autorizim formal tek Verso sh.p.k. për të gjitha programet që ai disponon dhe konkretisht për ato të kërkuar në pikën 2.3.5 për mbrojtjen nga sulmet DDOS. Aq më tepër që vetë kompania shqiptare Verso sh.p.k. nuk disponon autorizim direkt nga kompania prodhuese A10 Netëorks. Referuar ekstraktit të ngarkuar në sistem kompania shqiptare “Verso” sh.p.k. rezulton në ortakëri me kompaninë kroate “Verso Altima” d.o.o. por sipas analizës rezulton se shoqëria tregtare shqiptare në pronësi 100% të një subjekti të huaj e regjistruar në QKB si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Shpk), ka personalitet juridik të veçantë dhe operon si një entitet i pavarur sipas legjislacionit shqiptar, pavarësisht faktit që kapitali i saj zotërohet në mënyrë tërësore nga një kompani e huaj. Në rastin konkret, sipas ekstraktit të QKB-së, VERSO SHPK ka formë ligjore SHPK dhe është një person juridik shqiptar. Për rrjedhojë, autorizimet, certifikatat apo referencat teknike të lëshuara në emër të shoqërisë mëmë “VERSO ALTIMA d.o.o.” nuk konsiderohen automatikisht të vlefshme për VERSO SHPK, përveç nëse në autorizim përcaktohet shprehimisht që vlejnë edhe për të gjitha filialet apo

shoqëritë ku subjekti huaj është ortak. Gjithashtu autorizimi i prodhuesit nuk është as i përkthyer në gjuhën shqipe as i noterizuar dhe nuk ka në asnjë moment të përcaktuar shprehimisht që autorizohen për të rishitur zgjidhjen DDOS apo të gjitha programet edhe filialet apo shoqëritë ku subjekti i huaj është i deklaruar si ortak. Se fundmi, për të qartësuar më tepër këtë situatë “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave” nëpërmjet një kërkesë për shpjegimin e plotësimit të kriterit të autorizimit të prodhuesit apo rishitësit të zgjidhjes për sulmet DDOS, realizuar më datë 31.07.2025 në sistemin elektronik të APP-së ka kërkuar 4 sqarim më të plotë nga Operatori Ekonomik “One Albania” sh.a. por përgjigja e marrë në datë 04.08.2025, është se Shoqëria Verso Shpk, duke qene se eshte ne pronësi kapitali 100% te kompanisë Verso Altima Doo me Seli ne Kroaci, operon me te gjitha te drejtat juridike dhe teknike të kësaj shoqërie. Duke mos paraqitur asnjë referencë ligjore apo faktike që keto dy kompani veprojnë si nje entitet i vetëm juridik dhe teknik, dhe qe kjo kompani eshte hapur ne formën” Dege e shoqërisë se huaj”. Për sa më sipër, në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit në pikën 2.3.5 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Pika 2.3.5 ISHTE:

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar dhe sekondar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDoS në disa perimetra sigurie (multi-layer DDoS protection, në të gjithë perimetrat e sigurisë (lokale, kombetare dhe ndërkombetare). Gjithashtu për platformen e përdorur për ofrimin shërbimit DdoS, operatori ekonomik duhet ta provojë duke paraqitur kontratën e blerjes/suportit të platformes respektive për mbrojtjen DdoS (me një kompani/ofrues shërbimi për të cilin duhet të paraqitet autorizim rishitje apo prodhuesi).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik për këtë shërbim, kontratës së blerjes/suportit të platformës respektive si edhe autorizimin si rishites/prodhues për kompaninë me të cilën operatori ka marrëveshje për këtë shërbim.

Pika 2.3.5 BËHET:

*2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar dhe sekondar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDoS në disa perimetra sigurie (multi-layer DDoS protection, në të gjithë perimetrat e sigurisë (lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare). Gjithashtu për platformën e përdorur për ofrimin e shërbimit DDoS, edhe në kushtet kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformës, Operatori Ekonomik duhet ta provojë duke paraqitur dokumentacion të plotë provues. Në rastin e blerjes së platformës nga të tjerë të paraqesë kontratën e blerjes/suportit të platformës respektive për mbrojtjen DDoS (me një kompani/ofrues shërbimi e cila duhet të disponojë autorizim rishitje apo prodhuesi). **Në rastet kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformës, të paraqitet një përshkrim i detajuar se si është hartuar zgjidhja, hardware dhe software që përdoren, struktura dhe bllokskema se si funksionon zgjidhja, si edhe certifikimin përkatës dhe akreditimin nga organet ndërkombëtare lidhur me produktin e prodhuar nga Operatori.***

*Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik për këtë shërbim, kontratës së blerjes/suportit të platformës respektive si edhe autorizimin si rishites/prodhues për kompaninë me të cilën operatori ekonomik pjesëmarrës ka marrëveshje për këtë shërbim. **Në rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është vetë prodhuesi, duhet të paraqesë dokumentacion provues lidhur me prodhimin e platformës dhe paisjeve që përdoren për këtë shërbim konkretisht një përshkrim i detajuar se si është hartuar zgjidhja, hardware dhe software që përdoren, struktura dhe bllokskema se si funksionon zgjidhja, si edhe certifikimin përkatës dhe akreditimin nga organet ndërkombëtare lidhur me produktin e prodhuar nga Operatori.***

III.1.2 Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur operatori ekonomik “One Albania” SHA ka dorëzuar në SPE:

- Marrëveshje për blerjen e zgjidhjes së mbrojtjes DDOS, lidhur ndërmjet One Albania SHA dhe “Verso” shpk, lidhur në vitin 2023.
- Letër autorizimi datë 26.03.2025 lëshuar nga A10 Networks, inc. në emër të shoqërisë “Verso Altima” d.o.o me përmbajtje si vijon: “Ne A10 Networks Inc., një korporatë nga

Delaware, me seli në 2300 Orchard Parkway, San Jose, California 95131, SHBA (A10 Networks), prodhues i themeluar me reputacion dhe zyrtar i produkteve të A10 Networks, me anë të kësaj konfirmojmë se “VERSO ALTIMA” d.o.o me seli të regjistruar në Horvayova 80a, Zagreb, 10000 Kroaci, është një rishitës i autorizuar me reputacion të mirë me A10 networks dhe në këtë cilësi, është i autorizuar nga A10 Networks për të tregtuar, shitur, ofruar, negociuar dhe lidhur kontrata në cilësinë e tij individuale për rishitjen e produkteve të A10 Networks”.

III.1.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 41, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe

vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.5 të shtojcës 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, si dhe referuar arsyes së skualifikimit sipas të cilës “....Për sa më sipër pika 2.3.5 konsiderohet e papërmbushur pasi në dokumentacionin e dorëzuar nuk vërtetohet lidhja midis rishitësit të autorizuar “Verso Altime” Doo edhe kompanisë me të cilën Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurë ka ardhur me marrëveshje “Verso” Shpk, Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik “One Albania” SHA ka dorëzuar në SPE dokumentin marrëveshje për blerjen e zgjidhjen e mbrojtjes DDOS ndërmjet “One Albania” SHA dhe “Verso” shpk , lidhur në vitin 2023, si dhe dokumentin Letër autorizimi datë 26.03.2025 lëshuar nga A10 Networks, inc. në emër të shoqërisë “Verso Altime” d.o.o. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar Komisioni konstaton se, shoqëria A10 Network inc. autorizon shoqërinë “Verso Altime” d.o.o për të rishitur, ofruar,

negociuar apo për të lidhur kontratë për produktet e shoqërisë A10 Networks, inc. Në rastin konkret referuar kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik “One Albania” Sha ka ngarkuar kontratën për blerjen e platformës nga “Verso” shpk dhe referuar kriterit të pikës 2.3.5 duhet të vërtetonte dhe të dorëzonte një autorizim të lëshuar në emër të shoqërisë “Verso” shpk nga A10 Networks inc, dokument të cilin operatori ekonomik e ka dorëzuar në momentin e dorëzimit të ankesës dhe mban datë 20.08.2025, pra pas hapjes së ofertave. Ndërkohë referuar ligjit për prokurimin publik dhe rregullave të prokurimit publik dokumentet e dorëzuara duhet të dëshmojnë gjendjen faktike të operatorit ekonomik në momentin e hapjes së ofertave. Akoma më tej nga verifikimi i materialeve të ndodhura në fashikullin administrativ rezulton se në zbatim të nenit 92 të LPP-së, në datë 31.07.2025 KVO i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik “One Albania” sha, për sqarim dokumentacioni lidhur me mbrojtjen Ddos. Në datë 01.08.2025 me shkresën me nr. 2604 prot., me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për sqarim datë 31.07.2025”, ka deklaruar se për përmbushjen e kriterit lidhur me shërbimin e mbrojtjes nga sulmet Ddos ka dorëzuar: kontratën për blerjen e zgjidhjes së mbrojtjes Ddos, me nr. 213 prot., datë 19.01.2024 me objekt “Marrëveshje për blerjen e zgjidhjes së mbrojtjes DDOS”, lidhur ndërmjet One Albania SHA dhe “Verso” Shpk (degë e shoqërisë me qendër në Zagreb, “Verso Altima” D.o.o), autorizimin e rishitjes për “Verso Altima” d.o.o nga prodhuesi A10 Networks inc. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik se “Verso” shpk është degë e shoqërisë “Verso Altima” d.o.o, Komisioni gjykon, se Autorizimi i ngarkuar në SPE, i lëshuar nga A10 Networks rezulton të jetë lëshuar për shoqërinë “Verso Altima” d.o.o. Autorizimi i A10 Networks për “Verso Altima d.o.o. (Kroaci)” NUK vlen automatikisht për “Verso sh.p.k. (Shqipëri)”, nëse kjo e fundit është shoqëri më vete (sh.p.k.) dhe jo “degë” e regjistruar e shoqërisë kroate. Që hallka e autorizimit të jetë e vlefshme, duhet ose (a) “Verso sh.p.k.” të jetë degë e regjistruar e “Verso Altima” d.o.o., ose (b) autorizimi i A10 të mbulojë në mënyrë të shprehur “filialet/deget/subjektet e lidhura” dhe të ketë një delegim me shkrim (p.sh. letër-autorizim/POA) që i jep tagra “Verso sh.p.k.” të veprojë në emër të “Verso Altima” d.o.o. Sipas nenit 9 të Ligjit 9901, datë 14.4.2008 “PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE”, një degë ka të njëjtin personalitet juridik si shoqëria mëmë dhe vepron në emër të shoqërisë. Nëse “Verso sh.p.k.” do të ishte degë e “Verso Altima” d.o.o., atëherë autorizimi i dhënë për mëmën do të mbulonte edhe degën, për sa kohë është e regjistruar si e tillë në QKB. Një sh.p.k. është person juridik i veçantë. Shoqëritë fitojnë personalitet juridik me regjistrim dhe përgjigjen me aktivet e tyre; pra, një sh.p.k. nuk është e njëjta gjë me shoqërinë mëmë (edhe kur mëma është ortak/e). Vetë fakti që shoqëria kroate është “ortak” te sh.p.k.-ja shqiptare nuk krijon përfaqësim automatik. Deklarimi “Verso sh.p.k. është degë e Verso Altima d.o.o.” bie ndesh me faktin që në QKB rezulton “Verso” sh.p.k. me “Verso Altima” d.o.o si ortak. Kjo nuk e bën automatikisht sh.p.k.-në degë apo përfaqësuese. Autorizimi i A10 për “Verso Altima” d.o.o. i vetëm nuk e mbulon automatikisht “Verso sh.p.k.” dhe as çdo autorizim të mëpasshëm “Verso sh.p.k. për ONE Albania sh.a”, përveçse kur: autorizimi i A10 Networks inc shprehimisht lejon sublicensim/delegim të “afilialet/deget/subjektet e lidhura”, dhe ekziston delegim me shkrim nga “Verso Altima” d.o.o. të “Verso” sh.p.k. që e lejon të veprojë në emër të saj për produktet/shërbimet e A10 Networks inc (ose A10 Networks inc e ka lëshuar autorizimin

drejtpërdrejt edhe për sh.p.k.-në). Pa këto, lidhja nuk është e vlefshme për të mbështetur veprime ndaj të tretëve (p.sh. ndaj ONE Albania sh.a) duke u mbështetur te autorizimi fillestar i A10. Lidhur me arsyetimin e KVO-së se: “...Gjithashtu autorizimi i prodhuesit nuk është as i përkthyer në gjuhën shqipe as i noterizuar”, Komisioni gjykon se, në nenin 24 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.20201 “Për përcaktimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, parashikohet se: “2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhëtshqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.” Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor duke qenë se jemi para procedurës së hapur mbi kufirin e lartë monetar referuar rregullave të prokurimit publik një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze. Vetëm në rastin e paraqitjes së dokumentit në gjuhë të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentat e tenderit bëhet i kërkueshëm vërtetimi i përkthimit dhe i noterizimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “One Albania” SHA qëndron pjesërisht.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit se: “Kriteri 2.3.3 “Për kapacitetin teknik” pjesë e DST-së, i cili parashikon se: “Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se është i regjistruar pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve nëntokësore të komunikimeve elektronike në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përmendura në listën e pikave të shërbimit të DST. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur duke paraqitur Vërtetimin për prezencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuara nga AKEP, të cilat dëshmojnë praninë e rrjetit nëntokësor të Operatorit Ekonomik në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përcaktuara në listën përkatëse. Shtrirja e rrjetit nëntokësor duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike Në kushtet kur Operatori Ekonomik nuk disponon një infrastrukturë të vetën me fibër optike pranë vendodhjes së Autoritetit Kontraktor, apo filialeve dhe degëve të Autoriteti Kontraktor, pranohet paraqitja e një kontratë qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEPi, si edhe shtrirja e rrjetit nëntokësor të operatorit më të cilin bashkëpunohet duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS), duke përmbushur kushtet e Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për të garantuar cilësinë e shërbimit të ofruar çdo operator pjesëmarrës, duhet të deklarojë çdo bashkëpunim apo nënkontraktor me dokumentacionin përkatës (konkretisht duke paraqitur kontratë me objekt për

çdo bashkëpunëtor apo subjekt mbështetës duke përcatuar qartësisht pikat që merren përsiper si edhe duke paraqitur edhe çertifikimin nga AKEP për operatorët me të cilët do të ketë bashkëpunim/nënkontraktim si edhe ATLAS për të vërtetuar prezencën e rrjetit nëntokësor për nënkontraktorët).” Kriteri konsiderohet i papërbushur pasi Operatori Ekonomik ka ngarkuar një vërtetim të lëshuar nga AKEP shumë të përgjithshëm i cili nuk specifikon në asnjë moment prezencën me rrjet fizik apo infrastrukturë nëntokësore për pikat dhe bashkitë e kërkuara në DST. Nga operatori ekonomik ne zgjidhjen teknike të propozuar thuhet shprehimisht se në pikat fundore do të vendosen pajisje të cilat suportojnë rrjetin LTE/4G për sigurimin e rrjetit backup, por operatori MC Netëoring nuk është i licensuar për rrjet LTE/4G dhe as nuk ka kërkuar mbështetje nga një operator tjetër për të siguruar këto rrjet. Kriteri gjithashtu konsiderohet i papërbushur për shkak të mos paraqitjes së një kontrate/marrëveshje mbështetëse për sigurimin e rrjetit privat LTE/4G, për sigurimin e rrjetit Backup”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në dokumentat e tenderit të ndryshuara, në shtojcën 9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pika 2.3.3 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Pika 2.3.3 ISHTE:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se është i regjistruar pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve nëntokësore të komunikimeve elektronike në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përmendura në listën e pikave të shërbimit të DST. Kjo kërkesë konsiderohet e përbushur duke paraqitur Vërtetimin për prezencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuara nga AKEP, të cilat dëshmojnë praninë e rrjetit nëntokësor të Operatorit Ekonomik në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përcaktuara në listën përkatëse. Shtrirja e rrjetit nëntokësor duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS).

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ofertues në këtë procedurë, duhet që secili prej tyre të dorëzojë Vërtetimin për ekzistencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (‘AKEP’), në përputhje me zërat e shërbimeve/mallrave që ai do të realizojë, bazuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve. Shtrirja e rrjetit nëntokësor duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS).

Pika 2.3.3 BËHET:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se është i regjistruar pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve nëntokësore të komunikimeve elektronike në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përmendura në listën e pikave të shërbimit të DST. Kjo kërkesë konsiderohet e përbushur duke paraqitur Vërtetimin për prezencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuara

nga AKEP, të cilat dëshmojnë praninë e rrjetit nëntokësor të Operatorit Ekonomik në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përcaktuara në listën përkatëse. Shtrirja e rrjetit nëntokësor duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS).

Në kushtet kur Operatori Ekonomik nuk disponon një infrastrukturë të vetën me fibër optike pranë vendodhjes së Autoritetit Kontraktor, apo filialeve dhe degëve të Autoriteti Kontraktor, pranohet paraqitja e një kontratë qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEP-i, si edhe shtrirja e rrjetit nëntokësor të operatorit më të cilin bashkëpunohet duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS), duke përmbyllur kushtet e Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për të garantuar cilësinë e shërbimit të ofruar çdo operator pjesëmarrës, duhet të deklarojë çdo bashkëpunim apo nënkontraktor me dokumentacionin përkatës (konkretisht duke paraqitur kontratë me objekt për çdo bashkëpunetor apo subjekt mbështetës duke përcatuar qartësisht pikat që merren përsiper si edhe duke paraqitur edhe certifikimin nga AKEP për operatorët me të cilët do të ketë bashkëpunim/nënkontraktim si edhe ATLAS për të vërtetuar prazencen e rrjetit nëntokësor për nënkontraktorët).

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ofertues në këtë procedurë, duhet që secili prej tyre të dorëzojë Vërtetimin për ekzistencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (‘AKEP’), në përputhje me zërat e shërbimeve/mallrave që ai do të realizojë, bazuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve. Shtrirja e rrjetit nëntokësor duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publik.

III.2.2 Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur operatori ekonomik “MC Networking” shpk ka dorëzuar në SPE:

- Dokumentin me nr. 1036/1 prot., datë 27.06.2025 me lëndë “Vërtetim”, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare me përmbajtje si vijon: “....sipërmarrësi MC Networking shpk është i regjistruar në AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe ka të drejtë t’i ofrojë ato në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren nr. 26, datë 16.08.2012 “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipërmarrësi MC Netëorking shpk ka paraqitur dhe publikuar të dhënat e rrjetit të tij të komunikimeve elektronike pranë Regjistrit Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS). Bazuar në të dhënat e depozituara dhe publikuara pranë sistemit ATLAS konfirmojmë se sipërmarrësi, sipërmarrësit MC Networking shpk ka shtrirje me rrjet me fibër, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Certifikatë e Konfirmimit të Njoftimit nr. 2023-AP-1.1_640/datë 03.10.2023 lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në emër të sipërmarrësit MC Networking shpk me anë të së cilit vërtetojnë se sipërmarrësi MC Networking shpk është regjistruar në “Regjistrin e Sipërmarrësve” për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

III.2.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat

profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që: “2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se është i regjistruar pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve nëntokësore të komunikimeve elektronike në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përmendura në listën e pikave të shërbimit të DST. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur duke paraqitur Vërtetimin për prezencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuara nga AKEP, të cilat dëshmojnë praninë e rrjetit nëntokësor të Operatorit Ekonomik në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përcaktuara në listën përkatëse. Shtrirja e rrjetit nëntokësor duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS).

Në kushtet kur Operatori Ekonomik nuk disponon një infrastrukturë të vetën me fibër optike pranë vendodhjes së Autoritetit Kontraktor, apo filialeve dhe degëve të Autoriteti Kontraktor, pranohet paraqitja e një kontrate qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEP-i, si edhe shtrirja e rrjetit nëntokësor të operatorit më të cilin bashkëpunohet duhet të jetë gjithashtu e publikuar në Regjistrin Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS), duke përmbushur kushtet e Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për të garantuar cilësinë e shërbimit të ofruar çdo operator pjesëmarrës, duhet të deklarojë çdo bashkëpunim apo nënkontraktor me dokumentacionin përkatës (konkretisht duke

paraqitur kontratë me objekt për çdo bashkëpunëtor apo subjekt mbështetës duke përcatuar qartësisht pikat që merren përsiper si edhe duke paraqitur edhe certifikimin nga AKEP për operatorët me të cilët do të ketë bashkëpunim/nënkontraktim si edhe ATLAS për të vërtetuar prëzencën e rrjetit nëntokësor për nënkontraktorët”. Për përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE Dokumentin me nr. 1036/1 prot., datë 27.06.2025 me lëndë “Vërtetim”, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare me përmbajtje si vijon: “....sipërmarrësi MC Networking shpk është i regjistruar në AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe ka të drejtë t’i ofrojë ato në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren nr. 26, datë 16.08.2012 “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipërmarrësi MC Networking shpk ka paraqitur dhe publikuar të dhënat e rrjetit të tij të komunikimeve elektronike pranë Regjistrimit Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS). Bazuar në të dhënat e depozituara dhe publikuara pranë sistemit ATLAS konfirmojmë se sipërmarrësi, sipërmarrësit MC Networking shpk ka shtrirje me rrjet me fibër, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, Certifikatë e Konfirmimit të Njoftimit nr. 2023-AP-1.1_640/datë 03.10.2023 lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në emër të sipërmarrësit MC Networking shpk me anë të së cilit vërtetojnë se sipërmarrësi MC Networking shpk është regjistruar në “Regjistrin e Sipërmarrësve” për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik MC Networking shpk me arsyetimin se, “.....ka ngarkuar një vërtetim të lëshuar nga AKEP shumë të përgjithshëm i cili nuk specifikon në asnjë moment prëzencën me rrjet fizik apo infrastrukturë nëntokësore për pikat dhe bashkitë e kërkuara në DST. Nga operatori ekonomik ne zgjidhjen teknike të propozuar thuhet shprehimisht se në pikat fundore do të vendosen pajisje të cilat suportojnë rrjetin LTE/4G për sigurimin e rrjetit backup, por operatori MC Netëorking nuk është i licensuar për rrjet LTE/4G dhe as nuk ka kërkuar mbështetje nga një operator tjetër për të siguruar këto rrjet. Kriteri gjithashtu konsiderohet i papërbushur për shkak të mos paraqitjes së një kontrate/marrëveshje mbështetëse për sigurimin e rrjetit privat LTE/4G, për sigurimin e rrjetit Backup”, si dhe referuar kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar shprehimisht se në rastin kur vetë operatori ekonomik është i regjistruar pranë AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve nëntokësore të komunikimeve elektronike në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përmendura në listën e pikave të shërbimit të DST, kërkesa konsiderohet e përmbushur duke paraqitur Vërtetimin për prëzencën e infrastrukturës nëntokësore dhe Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të Sipërmarrësit, të lëshuara nga AKEP, të cilat dëshmojnë praninë e rrjetit nëntokësor të Operatorit Ekonomik në të gjitha pikat e shërbimit apo qytetet e përcaktuara në listën përkatëse, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE evidentohet se operatori ekonomik “MC Networking” shpk është i regjistruar në AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe ka të drejtë t’i ofrojë ato në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të dhënat e regjistruara dhe të publikuara pranë sistemit ATLAS,

konfirmohet se ka shtrirje me rrjet me fibër, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu operatori ekonomik ka dorëzuar edhe certifikatën e konfirmimit të njoftimit nr. 2023-AP-1.1_640/datë 03.10.2023 nëpërmjet të cilit AKEP konfirmon se “MC Networking” SHPK është regjistruar në “Regjistrin e sipërmarrësve” për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Në këto kushte referuar dokumentacionit të mësipërm Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ka ngarkuar dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit pikës 2.3.3, duke dëshmuar se përmbush kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se nëse autoriteti kontraktor kishte paqartësi lidhur me dokumentacionin e dorëzuar mund t’i kërkonte sqarime operatorit ekonomik referuar nenit 92 të LPP-së. Gjithashtu referuar nenit 124 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

III.2.8 Referuar arsyes së skualifikimit të KVO-së se MC Networking nuk është i licensuar për rrjet LTE/4G dhe as nuk ka kërkuar mbështetje nga një operator tjetër për të siguruar këtë rrjet. Kriteri gjithashtu konsiderohet i papërmbushur për shkak të mosparaqitjes së një kontrate/marrvëshje mbështetëse për sigurimin e rrjetit privat LTE/4G, për sigurimin e rrjetit Backup., si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e posaçme nga ana e autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të paraqesin një dokument provues që është i licensuar për rrjet LTE/4G. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit duhet të paraqesin në këtë fazë të procedurës një dokument për të vërtetuar nëse është i licensuar për rrjet LTE/4G. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomi është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit si vijon: *“2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një propozim e zgjidhjes teknike të zbatimit për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, i cili përfshin një përshkrim të detajuar dhe skemat përkatëse të rrjetit për çdo pikë, si dhe një strategji rezerve (back-up) për garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimit. Kërkesa për plotësimin e kapacitetit të pikës 2.3.4 do të konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik do të paraqesë propozimin teknik për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, duke përfshirë përshkrimet dhe skemat e rrjetit të ofruesit për secilën pikë, planin e backup për vazhdimësinë e shërbimit. Ky kriter konsiderohet i papërmbushur pasi zgjidhja teknike e*

propozuar nuk pasqyron skemat teknike te lidhjes per cdo pike, menyra e lidhjes se cdo pike dhe nuk tregon asgje per rrjetin qe zoteron operatori MC Networking per te siguruar redundancen e kerkuar per te arritur nivelin e kerkuar te sherbimit. Gjithashtu ne planin e Backup thuhet se do te vendosen paisje fundore qe kane suport per rrjet 4G/LTE, por nuk shpjegohet asnje topologji fizike apo logjike se si do te funksionoj ky rrjet. Gjithashtu ku kriter quhet i papermbushur edhe per shkak te mungeses se nje bashkepunomi me nje operator te licensuar per rrjetat 4G/LTE, pasi kjo zgjidhje kerkon te ngresh nje rrjet privat APN, per te arritur privatesine e kerkuar dhe bandëithin e kerkuar.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në pikën 2.3.4 të shtojcës 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një propozim e zgjidhjes teknike të zbatimit për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, i cili përfshin një përshkrim të detajuar dhe skemat përkatëse të rrjetit për çdo pikë, si dhe një strategji rezerve (back-up) për garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimit.

Kërkesa për plotësimin e kapacitetit të pikës 2.3.4 do të konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik do të paraqesë propozimin teknik për ofrimin e shërbimeve të kërkuara, duke përfshirë përshkrimet dhe skemat e rrjetit të ofruesit për secilën pikë, planin e back-up për vazhdimësinë e shërbimit.

III.3.2 Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

.....

III.3.3 Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit pikës 2.3.4 operatori ekonomik “MC Networking” shpk ka dorëzuar në SPE:

- Dokumentin “Propozim teknik: Implementimi dhe ofrimi i shërbimit intranet/internet për posta shqiptare sh.a”, datë 16.07.2025.

III.3.4. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, parrënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve...”*

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.6. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kërkesës së autoritetit kontraktor Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin, Dokumentin “Propozim teknik: Implementimi dhe ofrimi i shërbimit intranet/internet për Posta Shqiptare sh.a”, datë 16.07.2025. Nga verifikimi i dokumentave të tenderit, si dhe referuar arsyes së skualifikimit me arsyetimin se: *“.....Ky kriter konsiderohet i papërmbushur pasi zgjidhja teknike e propozuar nuk pasqyron skemat teknike të lidhjes për cdo pike, menyra e lidhjes së cdo pike dhe*

nuk tregon asgjë për rrjetin që zoteron operatori MC Networking për të siguruar redundancën e kërkuar për të arritur nivelin e kërkuar të shërbimit....”, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik konkretisht Dokumentin “Propozim teknik: Implementimi dhe ofrimi i shërbimit intranet/internet për Posta Shqiptare sh.a”, datë 16.07.2025, Komisioni konstaton se në propozimin teknik në pikën 5 specifikimet teknike të detajuara për ndërtimin e intranetit operatori ekonomik ka përcaktuar se: “MC Networking” do të ndërtojë infrastrukturën e intranetit duke përmbushur parametrat specifikë të kërkuar, bazuar në analizën e thellë të listës së ofruar: redundancë e rrjetit të brendshëm: ofrimi i linjës kryesore (uplink) në primary site (drejtoria e Përgjithshme e Postës) dhe në Disaster Recovery site (filiali Tirana) me fibër optike me kapacitet 10 Gbps, në dy drejtime të pavarura. Gjithashtu janë përcaktuar sistemet e “backup”-it dhe redundancës: MC Networking do të ketë sisteme “backup” që do të kufizojnë ndërprerjet në jo më shumë se 0.5 % të kohës dhe shërbimit. Zgjidhja teknike e ofruar do të demostrojë redundancë në nivel transmetimi në rrjetin tonë, duke përfshirë: ring connection (lidhja rrethore): midis dy pikave kryesore për të siguruar redundancë. Rrugëzime alternative: sigurimi i rrugëzimeve alternative për trafikun në rast të dështimeve të pajisjeve ose ndërprerjeve të linjave. 4G/LTE backup; për pikat me lidhje kryesore me fibra ose uireless, routerat me funksionalitet 4G/LTE do të shërbejnë si lidhje alternative, duke siguruar vazhdimësi operationale në rast të ndërprerjes së lidhjes primare. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për degët 8 Mbps, ku lidhja 4G do të jetë shpesh media primare ose e vetme e aksesit. Gjithashtu në pikën 6 Skemat e rrjetit përcaktohet se MC Networking do të ofrojë skema të detajuara të rrjetit kabllor dhe valor, duke ilustruar topologjinë dhe lidhjet e propozuara. Keto skema do të përfshijnë 6.1 skema e rrjetit kabllor- qendrat kryesore-datacenter primary site-Drejtoria e Përgjithshme e postës: qendra kryesore e të dhënave me serverat dhe infrastrukturën kryesore të rrjetit. Lidhja kryesore me fibër optike (FO) drejtpërdrejtë me rrjetin e MC Networking për transmetim të dhënash me shpejtësi të lartë. Disaster Recovery site-filiali tranzit: site rezervë për ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave. Lidhja me fibër optike (FO) e ndërlidhur me rrjetin e MC Netëorking. Rrjeti i operatorit MC Networking: ofrimi i lidhjes dhe monitorimit 24/7 të infrastrukturës. Sigurimi i ndërlidhjes së të gjitha filialeve dhe degëve të postës shqiptare përmes një topologjie ring për redundancë dhe vazhdimësi. Filialet dhe degët lokale: çdo filial dhe degë lidhet përmes router/fireëall me rrjetin e MC Networking. Lidhjet kanë shpejtësi të ndryshme sipas listës bashkëngjitur. Lidhjet dhe kapacitetet: Përdorimi i fibër optike (Fo) për lidhjet kryesore dhe ring Connection për redundancë. Monitorim i integruar për mbikqyrje në kohë reale.”. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ka përcaktuar në zgjidhjen teknike të ofruar prej tij se do të realizojë ofrim të lidhjes dhe monitorim 24/7 të infrastrukturës dhe se sigurimi i ndërlidhjes së të gjitha filialeve dhe degëve të postës shqiptare do të realizohet përmes një tipologjie Ring për redundancë dhe vazhdimësi. Gjithashtu ka paraqitur edhe në formë skematike skemën e rrjetit dhe ka paraqitur në mënyrë narrative se si do të realizohet lidhja për filialet rajonale, zyrat postare/nën degët, lidhjet me fibër optike, lidhjet valor/4G (degët me 8Mbps (ose 5Mbps). Gjithashtu në pikën 7.3 Plani i backup dhe redundancës operatori ekonomik “MC Networking” ka paraqitur planin e backupit për ofrimin e shërbimeve në çdo pikë, përmes mediave alternative, të cilat përfshijnë:

lidhje redundante: Ofrimi i lidhjeve alternative (fibër optike ose wireless) për pikat kritike. Pajisje me redundancë: Përdorimi i pajisjeve me komponentë redundantë 9 psh power supply të dyfishtë, module të shumta) [...]. Në këto kushte Komisioni gjykon se me zgjidhjen teknike të ofruara ka arritur të provojë se përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit pikën 2.3.4 të shtojcës 9 të dokumentave të tenderit.

Referuar arsytimit të KVO-së oër skualifikimin e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK si vijon: *“Gjithashtu ne planin e Backup thuhet se do te vendosen paisje fundore qe kane suport per rrjet 4G/LTE, por nuk shpjegohet asnje topologji fizike apo logjike se si do te funksionoj ky rrjet. Gjithashtu ku kriter quhet i papermbushur edhe per shkak te mungeses se nje bashkepunomi me nje operator te licensuar per rrjetat 4G/LTE, pasi kjo zgjidhje kerkon te ngresh nje rrjet privat APN, per te arritur privatesine e kerkuar dhe bandëithin e kerkuar, si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit Komisioni konstaton se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk është përcaktuar asnjë kërkesë e posaçme nga ana e autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të paraqesin një dokument provues që është i licensuar për rrjet LTE/4G. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit duhet të paraqesin në këtë fazë të procedurës një dokument për të vërtetuar është i licensuar për rrjet LTE/4G. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se skualifikimii operatorit ekonomi është bërë duke iu referuar një kriteri kualifikues të pakërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MC Networking” shpk për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit si vijon: *“...Kriteri 2.3.5 “Për kapacitetin teknik” pjesë e DST-së, i cili parashikon se: “Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet per linjën e internetit në site primar dhe sekondar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateëay Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDoS në disa perimetra sigurie (multi- layer DDoS protection, në të gjithë perimetrat e sigurise (lokale, kombetare dhe nderkombetare). Gjithashtu për platformën e përdorur për ofrimin shërbimit DdoS, edhe në kushtet kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformës, Operatori Ekonomik duhet ta provojë duke paraqitur dokumentacion të plotë provues. Në rastin e blerjes së platformës nga të tretë të paraqese kontraten e blerjes/suportit te platformes respektive per mbrojtjen DdoS (me nje kompani/ofrues sherbimi e cila duhet te disponoje autorizim rishitje apo prodhuesi). Ne rastet kur operatori ekonomik eshte vete prodhues i platformes, te paraqitet nje pershkrim i detajuar se si eshte hartuar zgjidhja, hardëare dhe softëare qe perdoren, struktura dhe bllokskema*

se si funksionon zgjidhja, si edhe certifikimin perkates dhe akreditimin nga organet nderkombetare lidhur me produktin e prodhuar nga Operatori.” Kriteri i mësipërm do të konsiderohet i papërmbushur pasi kontrata e ngarkuar e lidhur me “Vodafone Albania” sh.a. nuk përputhet me përshkrimin e kërkuar në kriter për programin DDOS. Konkretisht paketa DDOS Protect Basic siguron mbrojtje bazike DDOS dhe nuk përfshin funksionalitetin Multi- Layer i cili është opsion i vetëm që mbulon disa rrjete dhe ofron mbrojtjen e kërkuar në të gjithë perimetrat e kërkuar në DST nga Autoriteti Kontraktor. Referuar BGP.HE.NET operatori ekonomik rezulton se ka edhe tre “peer” të tjerë për të garantuar trafikun që janë përkatësisht Deft.com, Cogent Communication dhe One Albania, me kontratën e paraqitur cdo sulm DDOS i gjeneruar nga rrjeti apo i këtyre tre provider do të përfundojnë tek serverat dhe shërbimet e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, në lidhje me përmbushjen e kriterit të mësipërm nuk është ngarkuar asnjë autorizim prodhuesi për shërbimin DDOS protect lëshuar ndaj Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurë. Gjithashtu kriteri kërkon edhe ngarkimin e nje dokumenti teknik me zgjidhjen e ofruar per parandalimin e sulmeve DDOS, dokument i cili nuk eshte paraqitur, prandaj kriteri klasifikohet i papermushur ne lidhje me kete kerkese”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1 Në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumentave të tenderit të ndryshuar autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Pika 2.3.5 ISHTE:

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar dhe sekondar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDoS në disa perimetra sigurie (multi-layer DDoS protection, në të gjithë perimetrat e sigurisë (lokale, kombetare dhe ndërkombetare). Gjithashtu për platformen e përdorur për ofrimin shërbimit DDoS, operatori ekonomik duhet ta provojë duke paraqitur kontratën e blerjes/suportit të platformes respektive për mbrojtjen DdoS (me një kompani/ofrues shërbimi për të cilin duhet të paraqitet autorizim rishitje apo prodhuesi).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik për këtë shërbim, kontratës së blerjes/suportit të platformes respektive si edhe autorizimin si rishites/prodhues për kompaninë me të cilën operatori ka marrëveshje për këtë shërbim.

Pika 2.3.5 BËHET:

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar dhe sekondar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDoS në disa perimetra sigurie (multi-layer DDoS protection, në të gjithë perimetrat e sigurisë (lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare). Gjithashtu për platformën e përdorur për ofrimin shërbimit DDoS, edhe në kushtet kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformës, Operatori Ekonomik duhet ta provojë duke paraqitur dokumentacion të plotë provues. Në rastin e blerjes së platformes nga të tjerë të paraqesë kontratën e blerjes/suportit të platformes respektive për mbrojtjen DDoS (me një kompani/ofrues shërbimi e cila duhet të disponojë autorizim rishitje apo prodhuesi). **Në rastet kur operatori ekonomik është vetë prodhues i platformes, të paraqitet një përshkrim i detajuar se si është hartuar zgjidhja, hardëare dhe softëare që përdoren, struktura dhe bllokskema se si funksionon zgjidhja, si edhe certifikimin përkatës dhe akreditimin nga organet ndërkombëtare lidhur me produktin e prodhuar nga Operatori.**

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik për këtë shërbim, kontratës së blerjes/suportit të platformes respektive si edhe autorizimin si rishites/prodhues për kompaninë me të cilën operatori ekonomik pjesëmarrës ka marrëveshje për këtë shërbim. **Në rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është vetë prodhuesi, duhet të paraqesë dokumentacion provues lidhur me prodhimin e platformës dhe paisjeve që përdoren për këtë shërbim konkretisht një përshkrim i detajuar se si është hartuar zgjidhja, hardëare dhe softëare që përdoren, struktura dhe bllokskema se si funksionon zgjidhja, si edhe certifikimin përkatës dhe akreditimin nga organet ndërkombëtare lidhur me produktin e prodhuar nga Operatori.**

III.4.2 Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur operatori ekonomik “MC Networking” SHPK ka dorëzuar në SPE:

- Kontratën me nr. serial d44816d8-a48a-4a36-9074-dd797e8ff855, lidhur ndërmjet Vodafone Albania SHA dhe shoqërisë MC Networking shpk “Kontratë Pajtimi për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe audiovizive”, ku ndër të tjera përcaktohet se “Kushtet e përgjithshme të kësaj kontrate së bashku me anekset dhe formularin e pajtimit në rrjetin Vodafone (më poshtë referuar “Formulari i regjistrimit”) të nënshkruar prej të dy palëve, përbëjnë kontratën midis Vodafone Albania sha (më poshtë referuar “VODAFONE”) dhe kërkuesit të specifikuar në Formularin e regjistrimit (më poshtë referuar “pajtimtari”) [..].

- Dokumentin Propozim teknik: Implementimi dhe ofrimi i shërbimit Intranet/Internet për Posta Shqiptare sh.a ku ndër të tjera përcaktohet se: *“..MC Networking do të sigurojë mbrojtje nga sulmet DdoS (Distributed Denial of Service) për linjat e internetit në Primary Site dhe Secondary Site. Kjo arrihet përmes një zgjidhje të fuqishme dhe të integruar, e ndërtuar mbi shërbimin “Vodafone DdoS Protect”, duke shfrytëzuar ekspertizën dhe infrastrukturën globale të Vodafone. Monitorim, Njoftim dhe patrim automatik: [..]. Mbrojtje e Serverit dhe Infastrukturës BGP [..]. Mbrojtje Volumetrike dhe “scrubbing center” [..]. Mbrojtje Multi layer Ddos [..]. Suport Specialistësh dhe Integrim [..], si dhe ka paraqitur në formë skematike se si MC Netëorking në partneritet me Vodafone dhe shërbimin “Vodafone DdoS Protect”, do të mbrojë rrjetin e postës Shqiptare nga sulmet Ddos”.*

III.4.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.4.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.4.6. Në nenin 41, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*.

III.4.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.4.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.5 të shtojcës 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, si dhe referuar arsyes së skualifikimit sipas të cilës *“....Kriteri i mësipërm do të konsiderohet i papërmbushur pasi kontrata e ngarkuar e lidhur me “Vodafone Albania” sh.a. nuk përputhet me përshkrimin e kërkuar në kriter për programin DDOS. Konkretisht paketa DDOS Protect Basic siguron mbrojtje bazike DDOS dhe nuk përfshin funksionalitetin Multi- Layer i cili është opsion i vetëm që mbulon disa rrjete dhe ofron mbrojtjen e kërkuar në të gjithë perimetrat e kërkuar në DST nga Autoriteti Kontraktor. Referuar*

BGP.HE.NET operatori ekonomik rezulton se ka edhe tre “peer” të tjerë për të garantuar trafikun që janë përkatësisht Deft.com, Cogent Communication dhe One Albania, me kontratën e paraqitur cdo sulm DDOS i gjeneruar nga rrjeti apo i këtyre tre provider do të përfundojnë tek serverat dhe shërbimet e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, në lidhje me përmbushjen e kriterit të mësipërm nuk është ngarkuar asnjë autorizim prodhuesi për shërbimin DDOS protect lëshuar ndaj Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurë. Gjithashtu kriteri kërkon edhe ngarkimin e nje dokumenti teknik me zgjidhjen e ofruar për parandalimin e sulmeve DDOS, dokument i cili nuk është paraqitur, prandaj kriteri klasifikohet i papërmshur në lidhje me kete kerkese”, Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentin Kontratën me nr. serial d44816d8-a48a-4a36-9074-dd797e8ff855, lidhur ndërmjet Vodafone Albania SHA dhe shoqërisë MC Networking shpk “Kontratë Pajtimi për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe audiovizive”, ku ndër të tjera përcaktohet se “Kushtet e përgjithshme të kësaj kontrate së bashku me anekset dhe formularin e pajtimit në rrjetin Vodafone (më poshtë referuar “Formulari i regjistrimit”) të nënshkruar prej të dy palëve, përbëjnë kontratën midis Vodafone Albania sha (më poshtë referuar “VODAFONE”) dhe kërkuesit të specifikuar në Formularin e regjistrimit (më poshtë referuar “pajtimtari”), si dhe Dokumentin Propozim teknik: Implementimi dhe ofrimi i shërbimit Intranet/Internet për Posta Shqiptare sh.a. Referuar asryes së skualifikimit Komisioni konstaton se, në Kontratën me nr. serial d44816d8-a48a-4a36-9074-dd797e8ff855, lidhur ndërmjet Vodafone Albania SHA dhe shoqërisë MC Networking shpk, në Aneksin 1 “Tabela e Shërbimeve dhe Tarifave”, përcaktohet shërbimet fikse të ofruara nga Vodafone dhe të zgjedhura nga operatori ekonomik “MC Networking” shpk, ku përcaktohet edhe shërbimi DdoS, Vodafone DdoS Protect Basic. Referuar arsyetimit të KVO-së se kjo është mbrojtje bazike DDOS dhe nuk përfshin funksionalitetin Multi- Layer, Komisioni konstaton, se në kontratën e paraqitur është përcaktuar shërbimi i ofruar duke mos përcaktuar detaje rreth këtij shërbimi. Lidhur me mënyrën se si do të ofrohet dhe do të realizohet ky shërbim operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin “Propozim teknik”: Implementimi dhe ofrimi i shërbimit Intranet/Internet për Posta Shqiptare sh.a, ku në pikën 4 të këtij “Qendra e Sistemeve të Monitorimit, menaxhimit operacional, help desk dhe suporti i sistemit”, ndër të tjera përcaktohet se: “..MC Networking do të sigurojë mbrojtje nga sulmet DdoS (Distributed Denial of Service) për linjat e internetit në Primary Site dhe Secondary Site. Kjo arrihet përmes një zgjidhje të fuqishme dhe të integruar, e ndërtuar mbi shërbimin “Vodafone DdoS Protect”, duke shfrytëzuar ekspertizën dhe infrastrukturën globale të Vodafone. Monitorim, Njoftim dhe patrim automatik: [..]. Mbrojtje e Serverit dhe Infrastrukturës BGP [..]. Mbrojtje Volumetrike dhe “scrubbing center” [..]. Mbrojtje Multi layer Ddos [..]. Suport Specialistësh dhe Integrim [..], si dhe ka paraqitur në formë skematike se si MC Networking në partneritet me Vodafone dhe shërbimin “Vodafone DdoS Protect”, do të mbrojë rrjetin e postës Shqiptare nga sulmet Ddos”. Në pikën mbrojtje Multi Layer DdoS përcaktohet se: “Shërbimi Vodafone DdoS Protect përdor 5 module që punojnë së bashku për të parandaluar kalimin e trafikut të ligjshëm, duke ofruar mbrojtje DdoS në disa perimetra sigurie (multi layer DdoS protection) nga verifikimi aktiv dhe njohja e anomalive, te analiza e protokollit, pastrimi dhe filtrimi i trafikut

në burim. Kjo mbulon të gjitha perimetrat e sigurisë (lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare), nga përcaktimi i sipërcituar evidentohet se ofrohet shërbimi Multi Layer, duke dhënë një indicie që shërbimi dDos për mbrojtje nga sulmet, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi dokumenti teknik “Implementimi dhe ofrimi i shërbimit Intranet/Internet për Posta Shqiptare sh.a.”, i cili përshkruan qartazi zgjidhje DDoS Multi-Layer (5 module, monitorim/analitikë, BGP, scrubbing center, filtrime në disa perimetra sigurie).

Pra sa më sipër arsyetuar lidhur me: Përmbushjen e kërkesës “DDoS Multi-Layer”, Komisioni gjykon, se Dokumenti teknik emërton shprehimisht “**Mbrojtje Multi-Layer DDoS**” dhe liston funksionale konkrete (monitorim aktiv, detektim anomalish, analiza protokollesh, BGP, scrubbing center).

Përfundim: Kërkesa funksionale “Multi-Layer” është e provuar shprehimisht. Etiketa “Basic” në Aneks është emër komercial i paketës, jo përkufizim teknik i mungesës së shtresëzimit. Pesha provuese i takon përmbajtjes së zgjidhjes të detajuar në dokumentin teknik, jo emërimit tregtar. Lidhur me përmbushjen e kërkesës për dokument teknik të zgjidhjes Komisioni konstaton, se: Dokumenti “Implementimi dhe ofrimi...” është ngarkuar dhe përmban arkitekturë, mënyrën e ofrimit, proceset e monitorimit/ndërhyrjes dhe komponentët (përfshi scrubbing, BGP, multi-layer). Pra pretendimi i KVO se “nuk është paraqitur dokument teknik” bie poshtë automatikisht nga ekzistenca dhe përmbajtja e këtij dokumenti.

Akoma më tej nëse autoriteti kontraktor kishte paqartësi lidhur me paketën e ofruar nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK mund t’i kërkonte sqarime lidhur me shërbimin e ofruar në përputhje me nenin 92 të LPP-së.

Lidhur me arsyetimin e KVO-së se: *“Gjithashtu, në lidhje me përmbushjen e kriterit të mësipërm nuk është ngarkuar asnjë autorizim prodhuesi për shërbimin DDOS protect lëshuar ndaj Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurë. Gjithashtu kriteri kërkon edhe ngarkimin e një dokumenti teknik me zgjidhjen e ofruar për parandalimin e sulmeve DDOS, dokument i cili nuk është paraqitur”*, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK, Komisioni konstaton, se në pikën a) të seksionit 1.1 Përkufizime dhe interpretime, të kontratës me nr. serial d44816d8-a48a-4a36-9074-dd797e8ff855, lidhur ndërmjet Vodafone Albania SHA dhe shoqërisë MC Networking shpk përcaktohet se: *“a) “autorizimi” përfshin autorizimin e përgjithshëm dhe autorizimet individuale lëshuar Vodafone për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike sipas ligjeve shqiptare ku përfshihet ofrimi i shërbimeve fikse”*, rrjedhimisht me nënshkrimin e kontratës ndërmjet palëve “Vodafone Albania sha dhe MC Networking shpk, shoqëria Vodafone albania SHA autorizon operatorin ekonomik MC Networking shpk për shërbimi DdoS objekt i kësaj kontrate. Komisioni gjykon, se kontrata është një marrëdhënie juridike midis palëve që njihet dhe rregullohet Kodi Civil, fakt i cili është shumë i rëndësishëm për autoritetin kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik duke pasur në vëmendje qëllimin e ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK, nuk cenon në thelb procedurën e prokurimit por përkundrazi, referuar dokumentacionit të paraqitur në (SPE), operatori ekonomik ankimes ka përmbushur kriterin e përcaktuar nga ana e

autoriteti kontraktor, pasi kontrata e dorëzuar është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komisioni gjykon se, për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatori ekonomik të vërtetojë që operatori ekonomik mund të sigurojë mbrojtjen nga sulmet DDoS, në rastin konkret operatori ekonomik ka dorëzuar kontratën e lidhur ndërmjet Vodafone Albania sha dhe operatorit MC Networking shpk, ku në pikën a/1.1 “Perkufizime” të kësaj kontrate përcaktohet se: “autorizimi” përfshin autorizimin e përgjithshëm dhe autorizimet individuale lëshuar Vodafone për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike sipas ligjeve shqiptare ku përfshihet ofrimi i shërbimeve fikse, duke evidentuar në këtë mënyrë që Vodafone është i autorizuar për të ofruar shërbimet të komunikimeve elektronike dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet kontratës së nënshkruar me nr. serial nr. serial d44816d8-a48a-4a36-9074-dd797e8ff855 shoqëria Vodafone albania Sha autorizon kundrejt pagesës operatorin ekonomik për përdorimin e këtij shërbimi. Akoma më tej në zgjidhjen teknike të ngarkuar në SPE operatori ekonomik ka paraqitur në mënyrë të detajuar se si do të realizohet mbrojtja nga sulmet DDoS.

Komisioni gjykon, se edhe kjo mënyrë disponimi, konkretisht me kontratën e dorëzuar e cila në përmbajtje të saj përfshin edhe autorizimin nuk bie në kundërshtim me asnjë akt ligjor apo nënligjor në fuqi, si dhe përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Pra në përfundim të analizës së fakteve, lidhur me përmbushjen e kërkesës për autorizim prodhuesi / e drejta për ta ofruar shërbimin, Komisioni gjykon, se:

Çfarë provon kontrata:

I) Vodafone ka autorizimet rregullatore për të ofruar shërbime fikse (neni 1.1/a).

II) Ekziston marrëdhënie kontraktore detyruese Vodafone Albania SHA me MC Networking, me Aneks ku përfshihet shërbimi “Vodafone DDoS Protect”.

Pika (I) vërteton që shërbimi është ligjërisht i ofrueshëm nga Vodafone në Shqipëri; pika (II) vërteton që MC Networking ka të drejtë kontraktore ta përdorë këtë shërbim për projektin (qasje legjitime dhe e blerë).

Në logjikën juridike, një kontratë dypalëshe e vlefshme, me objekt shërbimin DDoS të përdorshëm nga OE, është provë më e fortë sesa një “letër autorizimi” formale. Kontrata s’është premtim i lirë; është titull i plotë i së drejtës së përdorimit, me çmim, kushte dhe detyrime.

Konkluzion: Kriteri material “OE është i autorizuar të sigurojë shërbimin” është i përmbushur. Po të ishte kërkuar ekspres “format-letër” i veçantë, autoriteti duhej të përdorte nenin 92 të LPP për sqarim formal; (e drejta e përdorimit përmes kontratës) ekziston.

Parimi i mos-formalizmit të tepruar dhe roli i autoritetit kontraktor

Në prani të provave të sakta (kontratë + dokument teknik), çdo paqartësi procedurale duhej sqaruar me kërkesë zyrtare (neni 92). Si përfundim, skualifikimi mbi bazë etikete (“Basic”) ose mungesë formati (letra e ndarë) është joproporcional kur substanca e kriterit është e provuar.

Pretendimi I KVO-së për mungesë “autorizimi prodhuesi” në format letre nuk qëndron, pasi marrëdhënia kontraktore e vlefshme Vodafone Albania SHA me MC Networking, me objekt shërbimin Vodafone DDoS Protect, është provë e mjaftueshme dhe më e fortë e të drejtës së OE

për ta përdorur/ofruar shërbimin. Për më tepër, neni 92 i LPP imponon sqarim formal nëse kërkohet format specifik, jo skualifikim kur kriterit është e provuar.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik dhe dokumenteve të tenderit, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të bëjë verifikimet dhe monitorimet përkatëse, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MC Networking” shpk për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit si vijon: “Kriteri 2.3.6 “Për kapacitetin teknik” pjesë e DST-së, i cili parashikon se: “Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filiale të Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 20 (njëzet) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

a. 3 (tre) punonjës të certifikuar të rrjetit Cisco (ÇNA) ose ekuivalente. b. 2 (dy) teknike të certifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente d. 2 (dy) inxhinierë të certifikuar në siguri rrjeti.

Operatori Ekonomik nuk rezulton të ketë deklaruar të dhëna verifikuese për punonjësit e certifikuar, databaze online apo Nr identifikues certifikate që zotëron punonjësi, gjithashtu nuk rezultojnë as vetë certifikatat të jenë të ngarkuara në sistemin elektronik të APP-së. Për sa më sipër, në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e mësipërme nuk kualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1 Në pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumentave të tenderit të ndryshuar autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Pika 2.3.6 ISHTE:

2.3.6 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 30 (tridhjetë) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të çertifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a. 3 (tre) punonjës të çertifikuar të rrjetit Cisco (ÇNA) ose ekuivalente.
- b. 2 (dy) inxhinierë të çertifikuar në arkitekturë dhe dizajn rrjeti SCTE ose ekuivalente.
- c. 2 (dy) teknike të çertifikuar në nivel teknik SCTE ose ekuivalente.
- d. 2 (dy) punonjës të çertifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).
- e. 2 (dy) inxhinierë të çertifikuar në siguri rrjeti.
- f. 1 (një) punonjës të çertifikuar për menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.
- g. 1 (një) punonjës i çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose më shumë çertifikime. Diplomat e arsimit të lartë të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin zyrtar të njohjes dhe ekuivalencës nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat Universitare për secilin punonjës të specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit.
- Çertifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentat e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i çertifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmarrë, apo realizojnë sipas marrëveshjes.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri përpara publikimit të njoftimit të fituesit të nisjes së afateve të ankimit.

Pika 2.3.6 BËHET:

2.3.6 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimi Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare sh.a, përgjatë periudhës së parashikuar 4-katër vjeçare për secilën nga filialet sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të **paktën 20 (njëzet)** punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion, nga të cilët staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a. **3 (tre) punonjes të certifikuar të rrjetit Cisco (ÇNA) ose ekuivalente.**
- b. **2 (dy) teknike te certifikuar ne nivel teknik SCTE ose ekuivalente.**
- c. **2 (dy) punonjes të certifikuar në siguri informacioni (cybersecurity).**
- d. **2 (dy) inxhinieri të certifikuar në siguri rrjeti.**
- e. **1 (një) punonjes te certifikuar per menaxhimin e projekteve PMP ose ekuivalent.**
- f. **1 (nje) punonjës i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (ITIL) ose ekuivalente.**

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose më shumë certifikime. Diplomat e arsimit të lartë të përfituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin zyrtar të njohjes dhe ekuivalencës nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomat Universitare për secilin punonjës të specifikuar në pikën 2.3.6 të Kriteret të Veçanta të Kualifikimit.
- Certifikatat/Dëshmi e vlefshme për çdo punonjës të kualifikuar, të lëshuara nga organe/trupa të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e tyre të origjinës dhe jo nga site online, të paakredituara
- **Listëpagesave sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentat e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmarë, apo realizojnë sipas marrëveshjes.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri përpara publikimit të njoftimit të fituesit të nisjes së afateve të ankimit.

III.5.2. Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime	nëse	vlerësohet	e
nevojshme _____			

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrent” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th.

bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë	Po [] Jo []

(nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
---	--

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.
- Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.5.3. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur

një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke in referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.5.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.5.5. Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë

elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

III.5.6 Në përmbushje të kriterit të pikës 2.3.6 të shtojcës 9 të dokumentave të tenderit operatori ekonomik “MC Networking” shpk ka dorëzuar:

- Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi të nënshkruar dhe vulosur ku në pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) ka deklaruar se: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionit përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. Punonjës Po [x] jo []. Nëse, po, numri i punonjësve: 65”, si dhe ka listuar punonjësit duke përcaktuar gjeneralitetet, degën e diplomimit, si dhe certifikimet.

III.5.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret

kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit të pikës 2.3.6 kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e

Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, për Pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: deklaratë, për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), konkretisht ka deklaruar numrin e punonjësve, gjeneralitetet e punonjësve që disponon të dhëna mbi kualifikimet dhe dëshmitë/certifikimet e tyre.

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në këtë moment procedural të procedurës së prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti, pasi nga shqyrtimi dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që autoriteti kontraktor të këtë zbatuar momentin procedural që ligjvënësi i ngarkon autoritetit kontraktor në këtë fazë të shqyrtimit. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njuh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor në këtë fazë të procedurës pa respektuar anën procedurale sipas pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285, që ligjvënësi i ka ngarkuar autoritetit kontraktor, nuk është i drejtë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse

cilësia e punës/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes 49 së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në këtë fazë të procedurës së prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. Referuar kriterit të sipërcituar dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues, duke deklaruar punonjësit në përputhje me kriterin e kualifikimit.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit, gjykojmë se operatori ekonomik ka deklaruar se disponon punonjësit e kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.6 të kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në kriterin e veçantë të kualifikimit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Nga dokumentacioni i administruar në fashikullin administrativ nuk reezulton që autoriteti kontraktor t'i ketë kërkuar sqarime operatorit ekonomik lidhur me punonjësit e deklaruar dhe certifikimet e tyre. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë të procedurës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “One Albania” SHA mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Abissnet” SHA, Komisioni gjykon, se referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “One Albania” SHA do të mbetet e skualifikuar rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimes, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.7 Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Mc Networking” SHPK për lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik të operatorit ekonomik “One Albania” SHA, Komisioni gjykon, se referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “One Albania” SHA do të mbetet e skualifikuar rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik MC “Networking” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e 11 Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “One Albania” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

